

- не ги прибави доказите во рок од три дена од денот на приемот на барањето (член 37 став 4) и

- не одлучи по барањето во рок од 30 дена од денот на приемот на барањето (член 37 став 6).

Глоба во износ од 25 до 50 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на овластено то службено лице од надлежниот јавен орган од кој се побарани доказите и податоците ако не ги достави бараните докази и податоци во рок од три дена од денот на приемот на барањето (член 37 став 5).

Член 52-б

За прекршоци од членот 52-а од овој закон прекршочна постапка води и прекршочна санкција изрекува надлежен суд.“

Член 5

Подзаконскиот акт утврден со овој закон ќе се донесе во рок од 30 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 6

Започнатите постапки до денот на започнување на примената на овој закон ќе завршат согласно со законот по кој биле започнати.

Член 7

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“, а ќе започне да се применува со започнувањето на примената на Законот за општата управна постапка согласно со членот 141 од Законот за општата управна постапка („Службен весник на Република Македонија“ број 124/15).

L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR ZGJIDHJE PAQËSISHT TË KONTESTEVE TË PUNËS

Neni 1

Në Ligjin për zgjidhje paqësisht të kontesteve të punës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 87/2007 dhe 27/14), në nenin 37 në paragrafin 2 pas fjalës "nevojitet" shtohen fjalët: "të parashtrorë kërkesë për lëshimin e licencës nga paragrafi 1 i këtij neni dhe".

Pas paragrafit 2 shtohen pesë paragrafë të rinj 3, 4, 5, 6 dhe 7 si vijojnë:

"Formularin e kërkesës nga paragrafi 2 i këtij dhe dokumentacionin e nevojshëm për lëshimin e licencës nga paragrafi 1 i këtij neni i përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e punës në pajtim me ministrin e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

Personi i autorizuar zyrtar në ministrinë kompetente për punët nga sfera e punës që e mban procedurën ka për detyrë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi 2 i këtij neni me detyrë zyrtare t'i kërkojë provat dhe të dhënat që nevojiten për dëshmimin e përmbushjes së kushteve nga paragrafi 2 pikat 1, 3 dhe 5 të këtij neni nga organi publik kompetent.

Personi i autorizuar zyrtar nga organi publik kompetent prej të cilit janë kërkuar provat dhe të dhënat nga paragrafi 4 i këtij neni ka për detyrë t'i dërgojë provat dhe të dhënat e kërkuara në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Personi i autorizuar zyrtar nga paragrafi 4 i këtij neni ka për detyrë të vendos në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi 2 i këtij neni.

Kundër aktvendimit të lëshuar nga ministria kompetente për punët nga sfera e punës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit te Komisioni Shtetëror për Vendimmarje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës."

Paragrafët 3, 4 dhe 5 bëhen paragrafë 8, 9 dhe 10.

Neni 2

Në nenin 47 në paragrafët 1 dhe 2 fjalët: "ministri kompetent" zëvendësohen me fjalët: "Ministria kompetente".

Në nenin 3 fjalët: "Ministri kompetent" zëvendësohen me fjalët: "Ministria kompetente".

Neni 3

Në nenin 52 në paragrafin 1 pika në fund të fjalisë shlyhet dhe shtohen fjalët: "në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative."

Neni 4

Pas Kapitullit V shtohet Kapitull i ri V-a dhe dy nene të reja 52-a dhe 52-b, si vijojnë:

"V-a. DISPOZITAT E KUNDËRVAJTJES

Neni 52-a

Gjobë në shumë prej 25 deri më 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar në Ministrinë kompetente për punët nga sfera e punës, nëse:

-nuk i siguron provat në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 37 paragrafi 4) dhe

-nuk vendos për kërkesën në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 37 paragrafi 6).

Gjobë në shumë prej 25 deri më 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar nga organi publik kompetent prej të cilit janë kërkuar provat dhe të dhënat nëse nuk i dërgon provat dhe të dhënat e kërkuara në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 37 paragrafi 5)."

Neni 52-b

Për kundërvajtjet nga neni 52-a të këtij ligji procedurë të kundërvajtjes mban dhe sanksion të kundërvajtjes shqipton gjykata kompetente."

Neni 5

Akti nënligjor i përcaktuar me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 6

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me ligjin me të cilin kanë filluar.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", kurse do të fillojë të zbatohet me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).